

Fjala e mbajtur në promovimin e librit Cesk Zadeja në Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës

Jam shumë i nderuar që librit “Çesk Zadeja në muzikën shqiptare” po i kushtohet ky promovim. E përtej falënderimeve më të ngrohta për seksionin e arteve të ASHAK që e shqyrtoi dhe aprovoi librin për botim, për vetë ASHAK, kryesinë e Tij që organizon këtë promovim këtu në Prishtinë, posaçërisht sjell në vëmendje fjalën e kryetarit Kraja në promovimin e librit në Tiranë, i cili e çmoi thelbin e Zadejës me 1 fjali të vetme, citoj: "muzika e Zadejës në Kosovë ishte identitet".

Duke shprehur mirënjohjen time për qëndrimet vlerësuese për librin, do të dëshiroja që fare shkurt të përmendja disa të vërteta që lidhen me Zadejën, librin kushtuar atij dhe marrëdhënien e Zadejës me Kosovën.

1. Është fakt tashmë, që ky libër (jeta dhe vepra), i pari syresh që i kushtohet Atij si kompozitor botohet fillimisht në Kosovë. Ky botim i realizuar më së pari këtu në Prishtinë, merr një rëndësi të madhe, pasi pohon publikisht vlerën kryesore të Zadejës si një kompozitor mbarëkombëtar, ashtu siç Ai vërtet ishte; që e pranon atë si krijues fundamental të muzikës shqiptare pa kufij; e që njëherazi dëshmon se trashëgimia e Tij muzikore vlerësohet njëlloj, si në Tiranë ashtu edhe në Prishtinë, në Tetovë e kudo tjetër.

* 2. Është gjithashtu fakt që Zadeja ishte dhe mbetet një autor përbashkues mes nesh, si i pari kompozitor shqiptar, anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. I pranuar në vitin 1996, 1 vit para ndarjes së Tij nga jeta, mund të them se ky vlerësim për të ishte dhe mbeti ndër më të rëndësishmit, bile kur Ai e mësoi faktin e zgjedhjes tha: ky është nder e vlerësim i jashtëzakonshëm i cili i bëhet kulturës dhe artit tonë. Më tej, duke cituar Ali Podrimjen, Zadeja pohonte se "Kosova mbetet "flakë e hershme e ashtit tim". Me këtë titull, po në vitin 1996 Zadeja kompozoi poemën vokale “Kosova flakë e hershme e ashtit tim”, në tri kohë: “Rënkimi”, “Ninullë guri”, “Zgjoju Kosovë”, për kor, solist piano e instrumente perkusioni.

Në një këndvështrim, Zadeja na afroi edhe si Akademi Shkencash me njera tjetrën në një fushë specifike siç është muzika, pavarësisht se në kohën kur Ai u pranua si "anëtar i jashtëm" në ASHAK, Zadeja nuk mbante a gëzonte ndonjë status të dhënë prej Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Me rastin e 95 vjetorit të lindjes, pra këtë vit, Zadeja u shpall "Nderi i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë", "Pas vdekjes", që është një titull që kompenson sadopak atë që nuk e morri në gjallje të Tij.

3. Zadeja ka një meritë historike sa i përket qëndrimit ndaj muzikës që kompozohet në Shqipëri e Kosovë. Me një qartësi që e kanë vetëm personalitetet e mëdha, Ai e konsideronte një të vetme krijimtarinë muzikore që krijohet këtej dhe matanë kufirit politik. Për të nuk kishte thjesht, siç thuhet, kompozitorë kosovarë dhe muzikë kosovare, por kompozitorë dhe muzikë shqiptare që zhvillohej në Kosovë.

Edhe pse gjatë komunizmit ne në Shqipëri ishim të mbyllur dhe jo me kontaktet që do të duhej të kishim me botën muzikore, Zadeja e ndiqte me shumë kujdes dhe e inkurajonte pluralitetin e

stileve që konstatohet qartazi tek kompozitorët shqiptarë të Kosovës, pasi mendonte se: ... stili nacional në muzikë është një bashkim karakteristikash artistike në zhvillimin historik të kulturës muzikore të një populli. Dhe koha i dha të drejtë. Që të gjithë krijuesit e muzikës, pavarësisht stilit që kultivojnë dhe veprave që shkruajnë, janë pjesë e mozaikut të larmishëm të muzikës sonë kombëtare.

Zadeja ka dhënë një kontribut thelbësor për vënien në skenën e Teatrit të Operas në Shqipëri të operas së parë kombëtare në Kosovë, "Goca e Kaçanikut" me muzikë të Rauf Dhomit. Zadeja ishte promotori i realizimit të kësaj nisme në kohën kur drejtonte artistikisht Teatrin e Operas në Tiranë. Në diskutimin krijues pas premierës së operës, Zadeja duke e çmuar atë si një vepër të rëndësishme të literaturës muzikore skenike kombëtare tha: ...është e kuptueshme dhe plotësisht e ligjshme që krijuesit dhe interpretuesit tanë gëzohen për këtë sukses të vëllezërve kosovarë në fushën e krijimtarisë muzikore skenike. Nga ana tjetër, kompozitori i shquar Fahri Beqiri kujtonte me shumë emocion fjalët e Zadejës, citoj:mos e konsideroni veten si kompozitorë provincialë, Prishtina dhe Kosova kanë tipare evropiane e po ashtu edhe muzika që kompozohet aty!

4. Zadeja veç të tjerash, mbetet autori kryesor i muzikës shqiptare i cili përmes vizionit të tij për krijimin e një muzike kombëtare, integroi në muzikën e Tij larminë e muzikës popullore të Kosovës, të cilën e njihte shumë mirë. Psh, vetëm një prej veprave e shkruar mbi motive kosovare, "Suita korale me tema kosovare" është vlerësuar nga kritika muzikore evropiane si "një nga veprat më me vlerë të muzikës korale shqiptare". Këtu më duhet të theksoj se kompozitorët lokalë i referohen kryesisht muzikës popullore të zonës së tyre, kurse ata mbarëkombëtarë e shohin të gjithë hapësirën tingullore popullore shqiptare si të tyre, pa paragjykim, nga veriu në jug, nga lindja në perëndim. Prandaj muzika e Zadejës flet shqip tek të gjithë ata që e dëgjojnë, se më së pari u ngrit në nivelin e një gjuhe komunikimi të qartë e origjinale, se siç thotë populli "piu ujë" në të gjitha dialektet muzikore të shqipes, në Labëri, Toskëri e Gegëri, në Çamëri e tek Arbëreshët. Akademik Ballata e ka theksuar se Zadeja e përdori "idiomën muzikore kombëtare" me theks herë mbi elementin melodik e ritmik dhe herë në atë metrik, me prani elementesh herë të jugut e herë të veriut, por dhe t'atyre Arbëreshë të Italisë e të Shqiptarëve të Kosovës.

5. Zadeja kishte dhe një tjetër dimension, atë të mikut dhe kolegut të dashur me të gjithë brezat e kompozitorëve të Kosovës. Ishin ata dhe kritika muzikore në Kosovë që e çmuan Zadejën që në vitet 1970 si "kompozitori më i shquar shqiptar" dhe si kompozitori "që e ngriti muzikën shqiptare në nivel evropian". Zadeja i njohu nga afër dhe mbajti marrëdhënie miqësore dhe profesionale me veprat e tyre si me Lorenc Antonin, Akil Kocin, Rexho Mulliqin, Nexhmije Pagarushën, Fahri Beqirin, Rauf Dhomin, Krist Lekën, Ëngjëll Berishën, Viçenc Gjinin, Zeqirja Ballatën, Esat Rizvanollin, Mark Kaçinaron, Rafet Rudin etj, e deri tek krijuesit më të rinj. Kosova e shoqëroi Zadejën në çdo aspekt, deri në çastet e fundit të jetës, ku si e parathënë nga fati, i fundit student kompozitor i Zadejës ishte një student shqiptar nga Kosova. Nuk e di a është këtu sot me ne Trimor Dhomi!

Përtej sa thashë më sipër, libri për Zadejën, falë ASHAK do të qarkullojë në Kosovë, në mënyrë që Zadeja si personalitet dhe si trashëgimi muzikore të njihet akoma më shumë për vlerat dhe rëndësinë e Tij për kulturën dhe artin tonë. Prandaj si autor i librit dhe si kompozitor ju jam

mirënjohës, se nuk mbështetet thjesht botimin e një libri, por përmes tij mundësuat që Zadeja të rikthehej përsëri në Kosovë, në atë që ai e quante SHQIPËRIA PËRTEJ DRINIT!

Së fundi falënderoj profesore Suzana Jakupin për paraqitjen që i bëri librit, akademik Luan Mulliqin për moderimin, pianisten Lirika Pula për interpretimin e saj të veçantë për të nderuar figurën e profesorit tonë të dashur, si dhe shtëpinë botuese për cilësinë e lartë të botimit të tij.

Ju faleminderit!

Prishtinë 4 tetor 2022